



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 137 Prot.

Tiranë më 11/4 /2015

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 1.4.2015 në orën 16:00, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Miratimi i "Raportit mbi veprimtarinë e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile gjatë vitit 2014"
2. Raportimi i Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së për punën e kryer nga komisionet e vlerësimit të Thirrjes Nr. 7 dhe njohja me rezultatet paraprake të këtij procesi.
3. Miratimi i projekteve të përzgjedhura të Thirrjes 7.
4. Të tjera

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe anëtarëve të Bordit si më poshtë :

1. Z. Adrian THANO
2. Znj. Majlinda DHUKA
3. Z. Alban DUDUSHI
4. Z. Aldo MERKOCI
5. Z. Endri FUGA
6. Znj. Gelardina PRODANI
7. Z. Ismail ADEMI
8. Znj. Kozara KATI

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur mbledhjen rreth orës 16:00.

Menjëherë Kryetari i jep fjalën Drejtorit Ekzekutiv Kananaj i cili, pasi uron mirëserdhjen në selinë e re të AMSHC-së, propozon disa shtesa në rendin e ditës, si më poshtë:

1. *Marrja në shqyrtim e disa ndryshimeve në rregulloren e Amshc-së;*



2. Marrja në shqyrtim e bashkëpunimit me disa propozime të bera nga Fondacioni gjerman Friedrich Hebert Stiftung;
3. Marrja në shqyrtim e propozimit për ndarje të fondit në dispozicion të thirrjes 7 në dy pjesë, duke mundësuar kështu një thirrje të 8-të brenda këtij viti.

Përsa i përket propozimit të Drejtorit Ekzekutiv rreth pikave të rendit të ditës Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC u shpreh: "Lidhur me propozimet për shtesat në rendin e ditës në këtë mbledhje nuk mund të shpreh dakordësinë time për të marrë në shqyrtim dy pikat e para të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së. Kjo për arsye se Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së do t'i nevojitej më shumë kohë dhe material në dispozicion për të mundësuar më pas diskutimin e këtyre pikave."

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC tha: "Këto pika i kam nisur me e-mail në adresën e Kryetarit të Bordit dhe jam i gatshëm t'i sqaroj edhe më tepër tani, p.sh. përsa i përket pikës së dytë (Marrja në shqyrtim e bashkëpunimit me disa propozime të bëra nga Fondacioni gjerman Friedrich Hebert Stiftung) theksoj se një nga detyrat dhe misionet e agjencisë që unë drejtoj ka të bëjë me përkrahjen dhe rritjen e organizatave rinore. Do të doja të lidhja një memorandum bashkëpunimi me këto organizata dhe do të doja t'i përkrahja duke iu ofruar një ambient pune pranë ambienteve të AMSHC - së."

Në lidhje me pikën e parë të parashtruar për shqyrim nga Drejtori Ekzekutiv i AMSHC, anëtar i Bordit, Z. Endri Fuga pyeti: "Çfarë fusha konkretisht kanë nevojë për ndryshime në rregulloren e AMSHC-së?"

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC u përgjigj: "Ka disa pika dhe detaje që mungojnë. Sa më shpejt do t'ju dërgoj Rregulloren me ndryshimet e kërkuara dhe me shpjegime që të jetë sa më e qartë."

Kryetari i Bordi vazhdoi: "Në tryezën tonë të mbledhjes nuk kemi versionin e propozuar të rregullores së AMSHC-së, dhe mungesa e materialit e bën të pamundur diskutimin rreth kësaj çështje, dhe rrjedhimisht edhe një vendim rreth saj".

Znj. Majlinda Dhuka tha: "Jam shumë dakort me sa thotë kryetari, mendoj se duhet të na dërgoni një relacion shpjegues lidhur me ndryshimet që ju mendoni se janë të nevojshme."

Në lidhje me pikën e dytë të propozuar prej tij Drejtori Ekzekutiv sqaroi: "Mundësia e bashkëpunimit me Fondacionin gjerman Friedrich Hebert Stiftung është në fakt pjesë e punës së AMSHC-së. Kërkoj që të më jepet mundësia për të pasur të drejtën e dhënies së ambienteve të punës në kuadër të këtij bashkëpunimi."

Në lidhje me sa u tha më sipër Z. Aldo Merkoçi u shpreh: "Mendoj se ia vlen të bashkëpunohet dhe të mbështeten këto organizata dhe jam dakord që të kemi një relacion sqarues lidhur me ndryshimet e mundshme të Rregullores."

Znj. Kozara Kali pyeti: "Çfarë lloj mbështetje është kjo?"

Drejtori Ekzekutiv u përgjigj: "Është thjesht mundësia e dhënies së një ambienti pune pranë zyrave tona të AMSHC-së dhe kjo zyrë do të shërbejë thjesht si pike kontakti për këto organizata."

Në vijimësi të mbledhjes Z. Endri Fuga, duke lënë mënjanë diskutimin rreth pikës së bashkëpunimit me *Frirdrich Hebert Stiftung* pyeti: "A ka problem nëse e shpyjmë për mbledhjen e radhës diskutimin rreth ndryshimeve në Rregulloren? Në të kundërt nëse nuk pret koha unë propozoj që ta vlen t'u përfshijmë në rendin e ditës dhe ta diskutojmë sot."

Znj. Majlinda Dhuka vazhdoi: "Unë jam dakord, që ashtu siç propozon edhe Kryetari, nëse është nevojë të bëjmë një mbledhje tjetër për të diskutuar lidhur me çështjen në fjalë. Të përcaktojmë tani se sa kohë u nevojitet anëtarëve të Bordit dhe të fiksojmë një datë të përshtatshme për mbledhjen e radhës."

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC pyeti: "Atëherë a është e mjaftueshme koha prej rreth dhjetë ditësh për të realizuar me pas mbledhjen e radhës?"

Kryetari i Bordi pasi mori edhe miratimin unanimit të anëtarëve të tjerë, shprehu dakordësinë lidhur me parafolësin dhe rrjedhimisht u vendos që brenda datës 13.4.2015, të realizohet mbledhja e radhës gjatë së cilës do të shqyrtohen si pika të rendit të ditës dy ndër çështjet e propozuar nga Drejtori Ekzekutiv, si më poshtë :

1. Marrja në shqyrtim e disa ndryshimeve në rregulloren e AMSHC-së ;
2. Marrja në shqyrtim e bashkëpunimit me disa propozimeve të bera nga Fondacioni gjerman *Frirdrich Hebert Stiftung*.

Lidhur me pikën e tretë të propozuar për diskutim nga Drejtori Ekzekutiv i AMSHC, që ishte kërkesa për marrje në shqyrtim të propozimit për ndarje të fondit në dispozicion të Thirrjes 7 në dy pjesë, duke mundësuar kështu një thirrje të 8-të brenda këtij viti, Kryetari i Bordit Mbikqyrës u shpreh: "Mendoj se kërkesa të tilla duhet të bëhen dhe të hidhen për shqyrtim përpara se të shpallet thirrja e radhës dhe jo kur ky proces ka përfunduar. Për mendimin tim do të ishte më normale dhe llogjike që kjo kërkesë të shtrohej si pikë diskutimi në Mbledhjen e Bordit ku u bë përcaktimi i kritereve të Thirrjes si edhe shpallja e saj."

Z. Andi Kananaj u përgjigj: "E shtroj këtë kërkesë në këtë kohë duke pasur parasysh aplikimet që kanë ardhur pranë AMSHC-së dhe faktit se shumë prej tyre nuk kanë qenë të cilësishme së pritshme dhe nuk e kanë luptuar siç duhet idenë e bashkëfinancimit, prandaj propozoj që shuma prej 20% e akorduar për projektet me bashkëfinancim të ngelet jashtë kësaj thirrjeje dhe të shërbejë për një thirrje të dytë"

Në vijim të këtij diskutimi, nënkryetarja e BM, znj. Majlinda Dhuka u shpreh: "Mendoj se kërkesa në fjalë nuk është një kërkesë e re. Kështu u veprua edhe me buxhetin e kaluar. Agjencia

për Mbështetjen e Shoqërisë Civile duhet të sqarojë nëse kjo kërkesë është një praktikë që mund të vazhdojë të ndiqet ose jo. Aktualisht jemi duke diskutuar për fonde të cilat sjellin kontribute të tjera. Kemi rënë dakord që me qeverinë sllovene të miratojmë një bashkëkontribut, por aktivizimi i këtij kontributi financiar ndjek një cikël tjetër. Jemi në kushtet kur shanset që të kontribuojmë me bashkëfinancim janë të mëdha ndaj unë përkrah idenë e ndarjes së fondit në dispozicion të Thirrjes 7-të në dy pjesë, duke mundësuar kështu një thirrje të 8-të brenda këtij viti. Bashkimi European ka miratuar 2mln euro në mbështetje të shoqërisë civile. Nga ndihma e huaj në Shqipëri ka miliona euro mbështetje, por që fatkeqësisht nuk kanalizohen nga AMSHC sepse mekanizmat për grantdhënie nuk janë të mira. Ndaj le të rrisim forcën dhe mundësitë për bashkëfinancim."

Z. Endri Fuga vazhdoi: "Pra, nëse ne i përthithim këto fonde dhe i shtojmë ato ne mund të shpallim një thirrje tjetër me shumën e përfutur."

Anëtar i Bordit z. Alban Dudushi u shpreh: "Ky diskutim është ok në parim. Por, thirrja u shpall, çdo gjë ka qënë online dhe të gjithë kanë aplikuar në bazë të një informacioni që kanë marrë. Ne kemi bërë një mbledhje për këtë punë. Kur u shpall thirrja nuk u hodh ideja që të behej ndarja e fondit në dy pjesë. Pse duhet të rikthehemi te ky diskutim sot që ne duhet të miratojmë dhe të shpallim fituesit?"

Z. Endri Fuga u përgjigj: "Projektet aplikojnë mbi një shumë limit. Jam dakord që duhet të diskutojmë më tepër, por nuk shoh ndonjë problem lidhur me mundësinë e ndarjes së fondit. Ne po bëjmë një diskutim parimor."

Z. Alban Dudushi vazhdoi: "Po, por ky diskutim parimor na kufizon punën për më vonë. Pse duhet të diskutojmë këtë propozim shtesë dhe pse duhet që për një thirrje që duhet ta mbyllim tani ta ndajmë në dy pjesë?"

Në këtë moment të mbledhjes znj. Majlinda Dhuka shprehet: "Në fakt drejtori i AMSHC-së është informuar prej muajsh lidhur me propozimin për ndarje të buxhetit në dy thirrje. Ne duhet të jemi të kënaqur që kemi arritur të thithim një kontribut."

Z. Alban Dudushi: "Po, por ne nuk mund të ndërrojmë kaq kullaj rendin e ditës apo edhe kushtet e thirrjes. Ne nuk kemi qënë të informuar."

Znj. Majlinda Dhuka vazhdoi: "Kjo mundësi bashkëfinancimi mund të kishat dalë edhe pas thirrjes. Por më tepër ende nuk është marrë asnjë vendim."

Z. Aldo Merkoçi shprehet: "Lidhur me kontributin që mund të përfitohet nga qeveria sllovene unë personalisht do të doja të sqaroja më tepër dy pika që lidhen respektivisht me shumën e këtij kontributi si edhe me objektin dhe fushën ku synon të shtrihet ky kontribut."

Në përgjigje të kërkesës së shtruar nga z. Aldo Merkoçi, znj. Majlinda Dhuka shprehet: "Kontributi slloven vjen në mbështetje të shoqërisë civile dhe më specifikisht lidhur me fushën e

mjedisit si edhe për dy shkolla të arsimit profesional në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë."

Z. Aldo Merkoçi vazhdon: *"Mesa jam i informuar ky kontribut nuk ka qenë tamam i lidhur me fushën e mjedisit dhe ideja lidhur me fokusin e bashkëfinancimit nuk ka qenë nëpërmjet AMSHC."*

Znj. Majlinda Dhuka sqaroi: *"Kontributi përfshin gjërësisht fushat që lidhen me shoqërinë civile si edhe fushat mjedisore, por nga këto ne mund të zgjedhim një prioritet me të cilin mund të harmonizohemi me qeverinë sllovene."*

Z. Endri Fuga vijoi: *"Pra parimisht, këtë total fondi ne mund t'ia shtojmë fondit tonë dhe nuk po themi që të djegim fondet. Shuma që do të fitojmë është e konsiderueshme dhe këtë shumë totale do ta shfrytëzojmë për një thirrje të dytë."*

Z. Aldo Merkoçi thotë: *"Ne parim e kemi diskutuar dhe e kemi të njohur si çështje, por duhet të na ishte bërë e ditur më parë dhe të ishim më të informuar për këtë çështje."*

Znj. Majlinda Dhuka sqaroi se: *"Dua të theksoj dhe të hej të ditur faktin se Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së ka qenë i pranishëm dhe ka qenë pjesë e të gjitha diskutimeve dhe takimeve të zhvilluara në lidhje me këtë çështje."*

Ndërhyn Z. Alban Dudushi: *"Drejtori Ekzekutiv duhet të kishte informuar anëtarët dhe kryetarin e Bordit për një gjë të tillë"*

Z. Ismail Ademi mori fjalën dhe tha: *"Janë dy çështje të cilat duhet t'i ndajmë. E para është, nëse interpretoj drejt edhe sa u tha nga kolegu Dudushi, çështje metode pune, pra mendoj se duhet të kemi më shumë shkëmbim informacioni dhe Drejtori duhet të na informojë më shumë rreth veprimeve që angazhojnë agjencinë. E dyta doja të pyesja në mënyrë specifike bashkëkontributi me qeverinë sllovene nënkupton që do krijojmë një fond të përbashkët i cili do të sub grantohet nga ne, si bëjmë me thirrjet e AMSHC-së, apo do ketë mekanizëm tjetër?"*

Znj. Majlinda Dhuka tha: *"Kemi dy opsione partneriteti pra kemi mundësi të bashkëpunojmë nëpërmjet bashkëfinancimit dhe kjo është shumë e rëndësishme."*

Kryetari i BM u shpreh në vazhdim: *"Është e qartë se sfida më e madhe e AMSHC-së është pikërisht rritja e kapaciteteve dhe thithja e fondeve."*

Znj. Kozara Kati ndërhyr në diskutim: *"Kam një pyetje në lidhje me opsionin e bashkëfinancimit dhe problematikës së hasur nga OJF që megjithëse kanë aplikuar ka rezultuar se nuk e kanë pasur shumë të qartë këtë proces. Ai i është referuar kësaj çështjeje gjatë takimeve informuese që ka organizuar AMSHC me OJF-të? A është trajtuar dhe a është sqaruar kjo çështje gjatë trajnimeve?"*

Drejtori Ekzekutiv u përgjigj: "Po, kjo çështje është trajtuar dhe ne mendonim se ishte e qartë. Por, mesa duket vetëm pak prej OJF-ve e kanë kuptuar ashtu siç duhet. Pjesa tjetër e kanë keqkuptuar. Kanë menduar sikur pjesa e fondit me bashkëfinancim do të ishte një fond të cilin ato do të duhej ta siguronin vetë. Prandaj, për këtë arsye ky opsioni i bashkëfinancimit ka dështuar si proces."

Znj. Kozara Kati u shpreh: "Ky rast përshën një precedent nga i cili duhen nxjerre mësim për të ardhmen. Lidhur me kontributin e qeverisë s'lovene doja të dija nëse ka afate kohore apo jo."

Znj. Majlinda Dhuka u përgjigj: "Afati që kishim propozuar ishte muaji maj ose muaji qershor."

Znj. Kozara Kati vazhdoi: "Atëherë ky fond nuk humbet dhe mund të përdoret edhe më vonë."

Znj. Majlinda Dhuka tha: "Varet edhe nga forca e organizatave, nga aftësia dhe mundësia e tyre për të përthithur fonde nga më shumë se një burim financimi."

Znj. Kozara Kati vazhdoi më tej: "Besoj se çështja e kërkesës për një ndarje të mundshme të fondit është e qartë për të gjithë anëtarët e Bordit, por duke iu referuar asaj çka tha edhe z. Dudushi, jam dakord me idenë se kur është shpallur kjo thirrje, është shpallur si një thirrje e vetme. Kjo gjë ka ndodhur edhe vjet dhe unë kam parasysh kritikën, pakënaqësitë dhe pikëpyetjet e organizatave lidhur me faktin që vetë qeveria hën ndarje të fondit. Kushtet dhe rregullat e lojës duhet të përcaktohen që në fillim dhe në mund të ndryshojnë në fund."

Z. Endri Fuga vazhdoi: "Jam dakord me këtë mendim në rast se ne do të kishim përcaktuar shumën maksimale të një projekti dhe nëse ne do ta ndryshonim këtë shumë maksimale. Në këtë rast do të kishim ndryshim të rregullave të lojës. Por, përderisa OJF-të aplikuese nuk çenohen sa më shumë thirrje të kemi uq më shumë cilësi dhe konkurrencë do të kemi."

Z. Alban Dudushi vazhdoi: "Nuk e kundërshtojmë këtë pikë parimish, por siç thashë duhet ta pranojmë e ta vendosim këtë gjë paraprakisht. T'i shpenzojmë fondet publike në mënyrën më të mirë. Nëse ka projekte të mira e cilësore duhet t'i përkrahim ato dhe nëse nuk mund t'i përkrahim atëherë ky është problem."

Në vijim të këtij diskutimi znj. Gelardina Prodani shprehet: "Ne nuk po ndryshojmë rregullat. Kemi shpallur një thirrje, por kjo nuk nënkupton që nuk mund të kemi edhe thirrje të tjera. Është e qartë që një pjesë e organizatave nuk e kanë kuptuar konceptin e bashkëfinancimit."

Kryetari i BM, z. Adrian Thano shtrën pyetjen: "Pra, kjo do të thotë se arsyetja pse propozohet kjo ndarje e fondit të thirrjes 7 është cilësia e dobët e projekteve aplikuese? Me sa kuptoj ky është arsyetimi i Drejtorit Ekzekutiv dhe propozuesve të ndarjes."

Znj. Kozara Kati vazhdon: "Në rastin e bashkimit të fondit me kontributet në fjalë sa pavarësi do të ketë AMSHC për të përzgjedhur projektet fituese apo do të ndikohet dhe do të cënohet kjo pavarësi nga bashkëfinancuesi?"

Znj. Dhuka përgjigjet: "Kemi gjithmonë mundësinë për të mos e pramur optionin e bashkëfinancimit."

Z. Aldo Merkoçi vijon: "Agjencia ka Bordin Mbikqyrës i cili duhet të marrë vendime pa u ndikuar nga qeveria."

Z. Endri Fuga u shpreh: "Nëse Drejtori Ekzekutiv i AMSHC kryen funksionin e tij duke pasur besimin tonë dhe duke na informuar ne do të marrim vendime mbi bazën e informacioneve që na jep Drejtori Ekzekutiv."

Z. Aldo Merkoçi thotë: "Pikërisht këtë dua të them edhe unë."

Z. Endri Fuga vazhdon: "Në çdo rast diskutimi e negociimi, në qendër duhet të jetë Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së si pjesë shumë e rëndësishme e këtyre diskutimeve e me pas të na informojë të gjithëve në kohë."

Në këtë moment të mbledhjes, Kryetari i Bordi Mbikqyrës të AMSHC vijon: "Me premtin se duhet të kemi më shumë transparencë dhe me arsyetimin e Drejtorit Ekzekutiv rreth cilësisë së dobët të projekteve si shkak propozimi për ndarjen e thirrjes së 7-të; hedhim në votë këtë pikë të shtuar të rendit të ditës, Kush është dakord që thirrja të ndahet?"

Pasi u hodh në votim ndarja e thirrjes u miratua me unanimitet

Në vijim të mbledhjes znj. Kozara Kati u shpreh: "Duke pasur parasysh takimin që AMSHC së bashku me përfaqësues nga Bordi Mbikqyrës, zhvilloi në datën 13 shkurt 2015, pranë zyrave të saj me përfaqësues me të lartë të Misionit të Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian dhe Zyrës së BE-së në Tiranë. Në këtë opinionin që ky mision kishte për qëllim të përgatiste dua të theksoj rëndësinë e këtij opinionit për AMSHC-në. Kur BE shprehet se AMSHC-ja nuk ka kredibilitet duhet marrë shumë seriozisht. Duhet të eliminojmë opinionet negative të cilat dëmtojnë reputacionin dhe kredibilitetin e AMSHC-së. Në të gjithë kemi mundësi që të rrisim reputacionin pozitiv të AMSHC-së nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës, realizimit të takimeve me donatorë të ndryshëm etj."

Z. Ismail Ademi tha: "Dua të nënvizoj faktin se funksionet ekzekutive që kanë lidhje me përditshmërinë e agjencisë është mirë që t'i kryej Drejtori Ekzekutiv i AMSHC së bashku me stafin e tij."

Znj. Kati u përgjigj: "Po, por ne si Bord Mbikqyrës duhet të ndikojmë dhe të kontribuojmë në këtë proces."

Në vijimësi të mbledhjes Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC, rikujtoi pikat e rendit të ditës. BM u shpreh unanimisht për miratimin e "Raportit mbi veprimtarinë e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile gjatë vitit 2014".

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, vijoi me një raportim lidhur me punën e kryer nga komisionet e vlerësimit të Thirrjes Nr. 7 si edhe me njohjen e rezultateve paraprake të këtij procesi duke u shprehur: *"Është ngritur një grup pune i cili është angazhuar tërësisht me kryerjen dhe analizimin e dosjeve të subjekteve përkatëse aplikuese duke filluar nga inspektimi ligjor i setit të dokumentave për të vijuar më tej me analizën narrative e së fundmi me kontrollin e formularit të prezantimit të buxhetit bazuar mbi shpërndarjen adekuate të zërave buxhetorë. Gjithashtu është përgatitur një material përmbledhës i tipit relacion lidhur me ato aplikime të dorëzuara pas afatit të paracaktuar përberë nga dy situata: e para dokumenta të cilat për efekt kohe nuk është mundur të dorëzohen në afat dhe e dyta: dokumenta të dorëzuara jashtë afatit të paracaktuar dhe me datë jashtë këtij afati për arsye të ndryshme duke filluar nga mosdijenja dhe deri në mosmundësinë e pajisjes me dokumentat e kërkuara në kuadër të realizimit të thirrjes. Aplikimet e përmendura në relacionin para jush (një kopje e relacionit shpërndahet tek secili anëtar i Bordit) nuk janë marrë në konsideratë nga anëtarët e komisionit duke ju hapur rrugën juve për një vendimmarrje."*

Më pas Kryetari i Bordit propozon të hedh në votim pranimin e projekteve në fjalë dhe pas votimit miratohet nga anëtarët e Bordit vetëm projekti i ardhur si aplikim pak minuata me vonë pas mbylljes së orarit zyrtar për pranimin e aplikimeve.

Më pas Drejtori Ekzekutiv shpërndan rezultatet paraprake me renditjen e projekt-propozimeve të Thirrjes Nr. 7 dhe secili prej anëtarëve të BM shqyrton rezultatet e paraqitura nga Drejtori dhe të përgatitur nga grupet vlerësuese të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Gjatë procesit të shqyrtimit të listës paraprake Z. Endri l'uga shprehët: *"Sugjeroj që në thirrjet e ardhshme, grupi vlerësues i stafit të AMSHC-së të bëjë edhe një përshkrim të shkurtër të projektit pasi vetëm me titullin sic paraqitet në këtë listë paraprake kuptohet vetëm pak rreth projektit. Secili aplikant të bëjë një vlerësim të projektit dhe një rekord të organizatës. Ky rregull sugjeroj të zbatohet në fillim të aplikimit dhe më pas t'i kalojë Bordit së bashku me listën paraprake të nxjerrë nga grupi i vlerësimit"*

Znj. Majlinda Dhuka shton: *"Sugjeroj gjithashtu që lista paraprake të paraqitet në formën e një projekt-vendimi shoqëruar me një relacion shpjegues për projektin e propozuar në listën paraprake si edhe me pika sqaruese për përmbajtjen e projektit. Ky projekt-vendim t'i paraqitet më pas Bordit për shqyrtim dhe më pas për miratim. Sugjeroj që vlerësimi të bëhet me anonimat organizate."*

Z. Isamil Ademi tha: *"Sugjeroj që tek formulari të përfshihet një pikë e cila do të kërkojë një abstrakt të shkurtër të projektit në mënyrë që të na lehtësojë vlerësimin në momentin e aprovimit të listës përfundimtare."*

Znj. Kozara Kati vazhdoi duke sugjeruar: "Të kemi edhe një referencë shpjeguese të projekteve të cilat janë skualifikuar nga lista paraprake gjatë procesit të vlerësimit nga grupi i punës. Gjithashtu do të sugjeroja edhe një monitorim të vetë grupit vlerësues të AMSHC."

Znj. Dhuka shprehet: "Ndoshta është koha kur vetë mënyra e funksionimit dhe organizimit të Bordit Mbikqyrës të AMSHC ka nevojë për ndryshime."

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC pyet: "Si sugjeroni të veprimet me kontratën e financimit lidhur me fazat e dhënies së grantit të përfutur?"

Znj. Dhuka përgjigjet: "Këtë mund ta përcaktojë më së miri vetë agjencia në varësi të punës së kryer dhe rezultateve të arritura."

Z. Endri Fuga vijon: "Do të ishte mirë nëse Drejtori Ekzekutiv dhe stafi i AMSHC-së do të organizonte vizita dhe takime të anëtarëve të BM për të parë më nga afër veprimtarinë e OJF-ve fituese."

Znj. Majlinda Dhuka shprehet: "Ligji thotë se grantet mbështesin politikat publike. Presumohet që nga gjithë këto grante të dhëna të kemi me pajetër një produkt fundor. Pyetja që ngre unë dhe që theksoj se është shumë e rëndësishme është kjo, ku janë rezultatet dhe produktet dhe si transmetohen konkretisht këto produkte që prodhohen nga këto OJF-të fituese?"

Z. Isamil Ademi shprehet: "Jam plotësisht dakord që të monitorohet më mirë puna dhe aktiviteti i këtyre OJF-ve."

Pas këtyre diskutimeve dhe sugjerimeve vazhdoi edhe më tej shqyrtimi i rezultateve të nxjerra nga vlerësimi i projekteve nga grupi i vlerësimit të AMSHC-së.

Më pas Kryetari i Bordit Z. Adrian Thano hodhi në votim miratimin e projekt propozimeve duke u bazuar tek vlerësimi dhe pikëzimi nga stafi i AMSHC-së dhe pas votimit u miratuan lista e projekteve fituese nga anëtarët e Bordit Mbikqyrës të AMSHC.

Për shkak të konfliktit të interesit Anëtarja e BM znj. Prodani nuk ishte e pranishme në aprovimin e projektit Nr.185.

Lista e miratuar e projekteve fituese të Thirrjes Nr. 7 është si më poshtë:

Nr.	Nr. Dosjes	Emri i OJF-së	Titulli i Projektit	Grupi nga Bordi	Piket e Bordit	Shuma e akorduar nga AMSHC (në Lekë)
1	2	Qendra "Art, Kulturë, Integrim"	Komunikimi bashkëkohor demokratik	A	83	2,400,000
2	5	Shoqata për Integrimin dhe Zhvillimin Komunitar	Fuqizimi i të rinjve në zonat rurale përmes trajnimeve profesionale dhe zhvilluese	A	87	1,000,000

3	6	Qendra për Zhvillim Ekonomik & Marrëdhëniet Ndërkombëtare (QZHEMN)	Integrimi i minoritetit rom, tregues i një shoqërie Demokratike	A	84	800,000
4	16	Millennial Hope	Radio-online- Inkurajimi i Debatit Publik dhe Demokratik	A	87	1,000,000
5	18	Unioni European Shqiptar	Studim dhe ndërgjegjësim për bizneset e vogla dhe të mesme të qytetit të Fierit; Lushnjës dhe Beratit në lidhje me zëvendësimin e qeseve plastike me ato të letrës, si vazhdimësi e ndërgjegjësimit të materialeve përbërëse të qeseve në të gjithë Republikën e Shqipërisë	A	82	2,000,000
6	27	Youth Act Center	Karta rinore evropiane (European Youth Card) si një mjet për fuqizimin e vullnetarizmit rinor, në kuadër të anëtarësimit të YouthACT në rrjetin ndërkombëtar evropian të EYCA-s	A	94	2,200,000
7	41	Qendra Optimum (NOSD)	Pjesëmarrja qytetare në monitorimin e fondeve publike	A	81	2,000,000
8	57	Qendra për Zhvillim dhe Iniciative Sociale (CDS)	Fizibiliteti empirik i një programi për prinderit femijet e të cieve vuajnë nga çregullimet e spektrit të autizmit	A	83	900,000
9	59	Qendra Shqiptare për Konkurrencshmëri dhe Treglinë Ndërkombëtare (ACIT)	Përmirësimi i qeverisjes ekonomike me anë të rrjetit të transparencës, aksesit në informacion dhe fuqizimit të analizave të pavarura në fushën e tregtisë	A	84	1,000,000
10	65	Instituti i Studimeve Publike & Ligjore (ISPL)	Demokracipërmes Referendumit: Forumi i kulturës dhe praktikës së referendumit në Shqipëri	A	82	1,500,000
11	69	Integration and Development Center (IDC)	Karrieri nuk është destin për personat me aftësi të kufizuara – ai mund të luftohet duke krijuar shprehje të duhura	A	82	1,800,000
12	72	Aleanca e Shoqërisë Civile	Mos e ngri dorën – Stop dhunës ndaj grave	A	81	2,000,000
13	77	Qendra për Shfletin e së Drejtës dhe Demokratizimin	Inkurajimi i qytetarisë aktive	A	86	3,500,000
14	81	Instituti i Buqës së Biologjike (IBB)	Përmirësimi i sigurisë ushqimore dhe ndërgjegjësimi i vullnetarizmit të të rinjve për të promovuar produktet tipike	A	85	1,700,000
15	82	Instituti për Menaxhimin e Mjedisit e Territorit (IMMT)	Promovimi i mbrojtjes së mjedisit në Korçë dhe fuqizimi i organizatave të të rinjve	A	83	1,500,000
16	90	Agjencia për Njerezit në Nevojë (ANN)	Ndërgjegjësim dhe sensibilizim i opinionit publik rreth problemeve të personave me aftësi të kufizuara	A	84	1,900,000
17	91	Qendra për Zhvillim Ekonomik (QZHE)	Zhvillimi i qëndrueshëm – Promovimi i një modeli të ri social	A	81	2,700,000
18	92	Agjencia për Iniciatva Sociale (AIS)	Vullnetarizmit rinor - Hap i ri drejt integrimit evropian	A	81	2,000,000
19	93	Unioni Rajonal i Shoqërisë Civile - (URSHC)	"Capacity building" i organizatave të shoqërisë civile në Shkodër	A	81	2,600,000
20	107	RINALB	Rruga e ndërgjegjësimit ambientalist tek të rinjtë	A	85	1,200,000
21	108	Qendra "J&K"	Të gjithë të ndryshëm. Të gjithë të barabartë	A	81	2,000,000

22	118	Dress for Success Trans	Mbështetja e grave vulnerable, drejt një punësimi të sigurtë, nëpërmjet përqasjes së re Dress for Success	A	81	1,500,000
23	119	Qendra Kombëtare për Studime Sociale (QKSS)	Nxitja e punësimit, vetëpunësimit dhe sipërmarrjes së lirë – si një mjet për përfshirjen shoqërore të të rinjve nga grupet e përjashtuara të romëve dhe PAK	A	84	2,400,000
24	122	Qendra Kulturare "AULONA"	Kohezioni Social Kulturor përmes Trashëgimisë Shpirtërore	A	88	600,000
25	126	Qendra "Mbështetje Informacion, Kujdes, Edukim (MIKE)	Vullnetarë në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve të veprimtar	A	83	2,200,000
26	129	Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajza	Ngritja e Linjës Kombëtare për viktimat e dhunës në familje. Rritja e informimit dhe dialogut për më shumë të drejta të grave	A	86	2,000,000
27	131	Qendra URA	Festivali i Veprave të Ndaluara	A	83	1,900,000
28	134	Fondacioni "BLEKALB"	Zhvillimi i kapaciteteve të të rinjve dhe në komunitetin e fermerve në zonat rurale në luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e transparencës në vendimarrje dhe në përdorimin e fondeve publike në infrastrukturën dhe shërbimet bujqësore e biektorale	A	83	500,000
29	137	Albanian American Trade & Development Association (AATDA-AL)	Forcimi i kapaciteteve institucionale të Shoqatës së Kooperativave Bujqësore Shqiptare (SHKBSSH) në funksion të përmirësimit të këmës së kooperimit në bujqësi në shqiptare	A	82	1,500,000
30	138	Qendra TULLA	Artësi si punëtor social	A	82	1,000,000
31	139	Organizata "Përtej Barrierave"	Vullnetarët: Pasion, Aksion, Impakt	A	83	500,000
32	149	Fondacioni Mireasia	Guidë për nisime kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergji brenda shoqërisë civile	A	81	1,000,000
33	158	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve	Mobilizimi i rinisë dhe i komunitetit për llogaridhënie të zyrtarëve publikë	A	82	2,500,000
34	175	Qendra për Shërbime Mjedisore	Modele të reja për menaxhimin e mbetjeve të ngurta	A	86	2,000,000
35	177	Agjencia për Zhvillim Ekonomik dhe Social (AZHES)	Monitorimi i Strategjive të Zhvillimit Vendor në Qarkun e Kukësit	A	82	2,500,000
36	178	Agjencia për Zhvillim Social (AZHS)	Integrimi i komunitetit rom në qytetin e Korçës	A	83	2,600,000
37	179	Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Qëndrueshmëri - QSHZHQ	Po bimëve medicinale – Jo dëmtim të biodiversitetit	A	84	2,000,000
38	180	Agjencia për Zhvillim Rinor (AZHR)	Rini aktive – Promovimi i formave agregative rinore	A	84	2,500,000
39	181	Instituti për Konsulencë në Menaxhim dhe Marketing (MMC)	Mjedis dhe mbrojtja e tij si prioritet social për ndërgjegjësimin e qytetarëve	A	83	2,000,000
40	185	Volart Production	Buxhet për qytetarët	A	83	2,000,000

41	186	Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm (QZHC)	Krijimi dhe hartimi i një platforme mbi instrumentat e zhvillimit komunitar	A	2,500,000
----	-----	---	---	---	-----------

Në përfundim të mbledhjes Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC kujton edhe njëherë vendimet e miratuara në këtë mbledhje. Ai rikujton gjithashtu se mbledhja e radhës do të zhvillohet në datën 13.4.2015 dhe parashtron paraprakisht dy ndër pikat e rendit të mbledhjes në fjalë të cilat do të jenë:

1. Marrja në shqyrtim e propozimit të Drejtorit Ekzekutiv për disa ndryshime në rregulloren e AMSHC-së.
2. Marrja në shqyrtim e propozimit të Drejtorit Ekzekutiv për disa propozime bashkëpunimi të bëra nga Fondacioni gjerman Friedrich Hebert Stiftung.

Të gjithë anëtarët e pranishëm aprovuan dhe firmosën për vendimet e propozuara.

Mbledhja u mbyll në orën 18:20.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adrian THANO

Kryetar i Bordit Mbikqyrës



Majlinda DHUKA

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës



Alban DUDUSHI

Anëtar



Albana Kociu

Anëtare

Aldo MERKOCI

Anëtar



Endri FUGA

Anëtar



Gelardina PRODANI

Anëtare



Ismail ADEMI

Anëtar



Kozara KATI

Anëtare

